



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.353/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Rustem Thaçi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Kushtrim Zuka, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me objekt të çështjes, mbajtja e tubimit publik gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, paautorizim nga Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ), në Ferizaj, në seancën e panelit, të mbajtur me datë 11.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet e palejuar ankesa A.nr.353/2021 e datës 08.02.2021, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 08.02.2021, nga Organizata Joqeveritare Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në të cilën theksohet se me datë 07.02.2021, në restorantin “Ujvara” në Komunën e Ferizajt, është mbajtur një tubim publik nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i cili tubim nuk ka qenë i lajmëruar në KKZ, përkatësisht tek Zyrtari i Lartë Komunal i Zgjedhjeve. Duke u bazuar në nenin 2, par. 2, në lidhje me nenin 4, par.2 i Rregullës Zgjedhore numër 13/2013, Fushata e Zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike, konsiderojmë se subjekti politik PDK, ka shkel këto nene, në momentin që ka vendosur të mbajë tubim publik të pa paralajmëruar (autorizuar) më parë. Parashtruesi i ankesës, ka bashkangjitur një fotografi të printuar si dëshmi për mbajtjen e tubimit publik.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj lejueshmërinë ankesën gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Me dispozitën ligjore të nenit 7 paragrafi 2 i Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2013, përcaktohet se: *“Nëse ZLKZ-ja, ose Zyrtaret e Policisë së Kosovës hasin në tubim publik të paautorizuar, ata duhet të informojnë PZAP për hollësitë e tubimit publik: për kohën, vendin, numrin e pjesëmarrësve në atë tubim publik, për subjektin politik*

që e mban tubimin publik, si dhe çdo informatë tjetër relevante lidhur me atë tubim publik".

Paneli vlerëson se nga dispozita e lart cituar, rezulton se të drejtën për ta informuar PZAP, lidhur me rastet e mbajtjes së tubimeve elektorale-publike pa autorizim, gjatë fushatës zgjedhore, e kanë vetëm ZLKZ-ja ose Zyrtaret e Policisë së Kosovës, e që në këtë rast ankesa është paraqitur nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), e cila nuk ka legjitimitet për te paraqitur ankesa të kësaj natyre, andaj si e tillë është hedhur e pa lejuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në Rregulloren Nr.02/2015 të PZAP-it, nenin 6 paragrafi 4, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.353/2021 më datën 11.02.2021

Kryesuesi i Panelit
Adnan Koshovci



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.